



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201500830/5

Tiranë, _____.2015

Lënda: *Rekomandohet marrja e masave për korrigjimin dhe anulimin e faturës të muajit gusht 2012, për abonentin B. Z., banues në Mallakastër, Fier.*

Drejtuar: **OPERATORIT TE SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE**
Administratorit, Z. Adrian ÇELA,

TIRANË

I nderuar z. Çela,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi **B. Z.**, i cili ankohet ndaj "OSHEE" sh.a., drejtoria rajonale Fier, lidhur me mbifaturim të energjisë elektrike, për kontratën me nr. F - 250455.

Konkretisht, ankuesi pretendon se në periudhën korrik 2012 - gusht 2012, është mbifaturuar në një sasi ekstreme prej 6012 kWh energji elektrike, kur matësi ka regjistruar 3411 kWh, por i njëjti fenomen ka ndodhur edhe në prill 2014. Ankuesi pretendon se megjithëse është ankuar vazhdimisht pranë zyrave të kujdesit ndaj klientit, përsëri problemi nuk ka gjetur zgjidhje ligjore.

Referuar ankesës, "OSHEE" sh.a., drejtoria rajonale Fier, bën me dije se, nëpërmjet shkresës nr. 3168 Prot., datë 29.09.2014, i ka kërkuar "OSHEE" sh.a., Tiranë, korrigjimin për sistemimin e klientit duke, **anulluar faturën e muajit gusht 2012; gjendja të fiksohet 2601 kWh si dhe fatura korrektive të gjenerohet sipas leximit korrekt të sistemit matës.**

Institucioni i Avokatit të Popullit, pasi ka verifikuar pretendimet e ankuesit, si dhe gjithë dokumentacionin bashkëngjitur nga "OSHEE" sh.a., drejtoria rajonale Fier, parashton shkeljet e konstatuara si më poshtë:

Nga ana e furnizuesit, qytetari është mbifaturuar dukshëm në krahasim me konsumin mesatar që ka pasur të faturuar rregullisht për çdo muaj, fakt ky që është vërtetuar dhe me procesverbalin e datës 01.09.2014, ku citohet se, gjendja e leximit për matësin ka qenë 3733 kWh dhe nga testimi, shkalla e gabimit ka qenë (-0.38 %), brenda klasit.

Me gjithë ankesat e vazhdueshme të abonentit dhe shkresës së "OSHEE" sh.a., drejtoria rajonale Fier, ende nga "OSHEE" sh.a., Tiranë, nuk është marrë asnjë masë për korrigjim dhe anulim të faturimit.

Sa sipër, gjykojmë se është shkelur neni 12 i Kontratës së Furnizimit me Energji Elektrike, që përcakton:

"... 12.5 Në rast se pas verifikimeve të Furnizuesit, rezulton se konsumatori është mbifaturuar atëherë Furnizuesi:

i. anulon faturën përkatëse dhe lëshon faturën e korrektuar".

Në këtë rast, konsumatori jo vetëm që është mbifaturuar, por ai detyrohet të provojë gabimin e strukturave tuaja, por pa asnjë rezultat.

Ankuesit në faturën muajit gusht 2012 i faturohet një detyrim në kundërshtim me nenin 40 të Ligjit Nr. 9902, datë 17.04.2008, "Për mbrojtjen e konsumatorit", ku përcaktohet se:

1. *Shitja e energjisë ... llogaritet në bazë të konsumit real dhe vlerësohet nëpërmjet aparateve matës ...*
4. *Faturat e paraqitura konsumatorit duhet t'i japin atij mundësinë për të verifikuar me përpikëri llogaritjen e shitjes ose shërbimit të siguruar në një periudhë të caktuar.*

Në përfundim, Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e parë vazhdimin e kësaj situatë, si shkak për cenimin e të drejtave dhe interesave të ligjshme të konsumatorit, në bazë të nenit 63/3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit ka drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga Administrata Publike...", si dhe në bazë të Nenit 21/b të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive",

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave të menjëhershme, për anulimin e faturimit për muajin gusht 2012, duke korrigjuar gjendjen në 2601 kWh, si dhe fatura korrektive të gjenerohet sipas leximit korrekt të sistemit matës.

Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, lutemi të informohemi brenda afatit 30 ditor, për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi.

Duke shprehur në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Etilda GJONAJ (SALIU)